



Kosovo Educational Research Journal

Volume 3, Issue 1, 86-126.

ISSN: 2710-0871

<https://kerjournal.com/>

Aspekti social dhe ndikimi i politikave sociale për fëmijë me nevoja të veçanta në Kosovë

Shefqet MULLIQI

University of Gjakova ``Fehmi Agani``

Abstrakti: Qëllimi i këtij punimi është që të hulumtohet gjendja e fëmijëve me nevoja të veçanta në Kosovë. Duke analizuar dhe kuptuar gjendjen sociale të fëmijëve me nevoja të veçanta, kam shqyrtuar dhe sugjeruar metoda për përmirësimin e gjendjes së tyre. Poashtu kam analizuar gjendjen e arsimit për fëmijët me nevoja të veçanta, me qëllim të vlerësimit të kushteve në arsim për këta fëmijë. Në këtë punim do të bëhet një hulumtim për politikat sociale ndërkombëtare dhe ato vendore, për të drejtat e fëmijëve me nevoja të veçanta si dhe aspektin real të gjendjes aktuale të fëmijëve me nevoja të veçanta. Nga hulumtimi do të arrij në përcaktimin e gjendjes aktuale të fëmijëve me nevoja të veçanta në Kosovë, duke përfshirë çdo aspekt: social, ekonomik, arsimor, shoqëror etj. Fëmijët me nevoja të veçanta janë një kategori që kanë nevojë për studim të hollësishëm dhe një hulumtim statistikor për gjendjen e tyre në Kosovë. Rëndësia e kësaj teme qëndron në informimin real të kushteve, ligjeve dhe përfshirjes sociale të fëmijëve me nevoja të veçanta. Përmes kësaj teme kam qëllim të paraqes gjendjen reale të kësaj kategorie dhe të specifikoj të metat që do të has ne trajtimin shoqëror e social të fëmijëve me nevoja të veçanta. Poashtu do të hulumtohet procesi i gjithëpërfshirjes në arsim, si një sfidë tjetër për fëmijët me nevoja të veçanta. Do të shqyrtohen hapat e ndërmarrë nga ministria e arsimit si dhe organizatat e ndryshme botërore, që veprojnë në vend, për zhvillimin sa më cilësor të këtij procesi. Përmes pyetësorëve të përgatitur do të arrijmë në përfundim për gjendjen në arsim të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe trajtimin e tyre nga shoqëria.

Fjalët kyqe: fëmijët me nevoja të veçanta, politikat sociale, korniza ligjore, fëmijët e verbër, fëmijët me sindromen Down.

To cite this article: Mulliqi, Sh. (2022). **Aspekti social dhe ndikimi i politikave sociale për fëmijë me nevoja të veçanta në Kosovë.** Kosovo Educational Research Journal, 3(1), 86-126.

Hyrje

Fëmijët, të cilët hasin në vështirësi gjatë proceseve jetësore si në të folur, shkruar ose mësuar, kanë nevoja të veçanta. Këta fëmijë i identifikojmë si fëmijë me aftësi të kufizuara. Këtu përfshihen personat që kanë kufizime në të ecuar, në të folur, shurdhmemecët, të verbrit, personat me autizëm, me sindromën Down etj. Pavarësisht kufizimeve fizike, ligji siguron mbrojtjen e barabartë ligjore. Të drejtat e tyre përfshihen në arsim, shëndetësi, mirëqenie sociale etj. Procesi gjithëpërfshirës në arsim, për nxënësve me nevoja të veçanta, mbetet akoma sfidë. Organizata të ndryshme ndërkombëtare, veprojnë në Kosovë, ofrojnë vazhdimisht përkrahjen e tyre për krijimin e kushteve sa më të përshtatshme për fëmijët me nevoja të veçanta si në arsim, shëndetësi dhe mirëqenie sociale. Përmes politikave sociale, shteti mund të siguroj kushte të përshtatshme që edhe këta fëmijë, si të gjithë fëmijët të tjerë, t'i realizojë ambiciet e tyre dhe të arrijnë suksese në jetë. Politikat sociale të vendit sigurojnë mirëqenien e çdo kategorie të shoqërisë, do të thotë edhe mirëqenien sociale të fëmijëve me nevoja të veçanta. Si një aspekt shumë i rëndësishëm i një vendi, politika sociale ndikon shumë në zhvillimin e një shteti. Prandaj në Kosovë punohet vazhdimisht për krijimin e mekanizmave të nevojshëm për përmirësimin e gjendjes sociale. Dihet që, me një papunësi të madhe dhe një ekonomi të dobët, është tejet i vështirë krijimi i kushteve të nevojshme për personat me nevoja të veçanta. Mungojnë kushtet për qasjen fizike nëpër shkolla dhe institucionet, stafi profesionist dhe akoma ekzistojnë paragjykitime e diskriminime për personat me nevoja të veçanta. Personat me nevoja të veçanta kanë të drejtën e arsimit, të drejtën e qasjes në institucionet shkollore e shëndetësore si dhe të drejtën e mirëqenies sociale. Mirëpo sa i gëzojnë ata këto të drejta, për Kosovën mbetet akoma sfidë që duhet tejkaluar. Procesi i gjithëpërfshirës në arsim po ashtu është një tjetër sfidë që Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në bashkëpunim me organizatat e ndryshme, po ndërmarrin hapa të vazhdueshëm, për ta tejkaluar. Ky proces gradualisht po shkon drejt përmirësimit përmes organizimeve të ndryshme të përkrahura, gjithmonë, nga institucionet shtetërore. Përpilimi i manualeve, punimeve dhe udhëzimeve të ndryshme po e lehtëson në mënyrë të dukshme këtë proces, duke u ndihmuar mjaft shumë mësimeve të ndryshme. Po ashtu një ndihmë të madhe po japin edhe trajnimet e mbajtura për mësimeve nga ana e organizatave të ndryshme. Është e njohur ndërkombëtarisht që të gjithë personat në shoqëri duhet të kenë të drejta dhe trajtim të barabartë. Përfshirja duhet të jetë e barabartë në çdo aktivitet shoqëror, edukativ, arsimor dhe në punësim. Pjesëmarrja e çdo personi në jetën shoqërore duhet të bëhet pa asnjë lloj diskriminimi si në moshë, gjini, race, status, dëmtim

etj. Një gjë e tillë vlen edhe për fëmijët me nevoja të veçanta, ata nuk duhet të veçohen nga fëmijët e tjerë, por të shoqërohen me fëmijët tjerë duke marrë përkrahje të barabartë si në shkollë, ashtu edhe në shoqëri. Gjatë historisë, personat me nevoja të veçanta, janë diskriminuar e përjashtuar nga shoqëria. Jeta e tyre ka qenë tërësisht e ndarë nga personat tjerë, duke përfshirë këtu edhe familjen dhe 10 miqtë. Në të shumtën e rasteve, prindërit, i kanë dërguar fëmijët në institucione ku edhe ka munguar edukimi i duhur. Me kalimin e kohës janë bërë ndryshime dhe janë ndërmarrë masa që shoqëria të vetëdijesohet për vlerën e brendshme që kanë këta persona. Sot, është shumë i rëndësishëm identifikimi me kohë i këtyre personave, në mënyrë që të marrin edukimin e duhur dhe të kenë jetë si të tjerët. Prandaj, është e rëndësishme, që të bëhet një hulumtim rreth gjendjes së fëmijëve me nevoja të veçanta, duke pasur parasysh me çfarë problemesh përballën ata në Kosovë. Ky hulumtim ka për qëllim të analizojë gjendjen sociale të këtyre fëmijëve, strategjitë dhe politikat që përdor shteti për të përmirësuar gjendjen e nxënësve me nevoja të veçanta.

Identifikimi i fëmijëve me nevoja të veçanta

Përgjegjës për identifikimin e fëmijëve me nevoja të veçanta janë prindërit, edukatorët, dhe mësime të ndërsa ligjërimit përgjegjëse janë institucionet shtetërore. Gjatë punës me fëmijë mund të vërehen aftësitë e kufizuara gjatë procesit të rritjes. Pasi që, shumë prindër, për shkak të paragjykimëve, hezitojnë t' i dërgojnë fëmijët e tyre me nevoja të veçanta në shkollë, institucionet shtetërore janë përgjegjëse për të identifikuar dhe monitoruar këta fëmijë. Një gjë e tillë mund të arrihet përmes bashkëpunimit në mes të institucioneve arsimore dhe atyre shëndetësore e të mirëqenies sociale. Shpesh terminologjia e përdorur për këta fëmijë nuk është e qëlluar, pavarësisht se kohëve të fundit ka ndryshime. Emërtimi “fëmijët me nevoja të veçanta” është më i përshtatshëm, sepse secili individ në këtë botë ka të përbashkëta me të tjerët, por edhe dallon nga të tjerët: secili njëri pra ka nevoja të veçanta. (Zabeli, Nxënës me nevoja të veçanta, 2001) Në shkollë përmes veprimtarive kurrikulare, përdoren metoda të ndryshme për të identifikuar veçoritë e nxënësve. Përmes këtyre metodave bëhet njohja e sjelljeve, e afatësive apo mungesës së aftësisë në aspekte të ndryshme. Në doracakun “Doracaku për identifikimin, vlerësimin dhe arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta”, të përgatitur nga Ministria Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, thuhet: “Tradicionalisht, shumë familje në Kosovë hezitojnë të dërgojnë fëmijët në shkollat për fëmijë me nevoja të veçanta”. Andaj, është shumë e rëndësishme që në mënyrë aktive të mblidhen informata për ata fëmijë, në mënyrë që t' u mundësohet atyre të arsimohen në një mjedis që merr

parasysh nevojat e tyre individuale. Për këtë arsye, Zyrtar Rajonale të Arsimit (ZRA) dhe Drejtoria Komunale për Arsim (DKA) duhet të bashkëpunojnë me Drejtorinë Komunale të Shëndetësisë dhe të Mirëqenies Sociale për të identifikuar fëmijët e tillë. (Ministria e Arsimit e Shkencës dhe Teknologjisë, 2007). Kur identifikohen fëmija, DKA duhet të kërkojë të bëhet një vlerësim i nevojave arsimore nga zyrtarët komunal apo regionalë të nevojave të veçanta apo të kontaktojë Sektorin e Nevojave të Veçanta në Ministri. Këta specialistë do të analizojnë secilin rast individual dhe do të përcaktojnë nevojat e tyre arsimore”. (Ministria e Arsimit e Shkencës dhe Teknologjisë, 2007).

Fëmijët me nevoja të veçanta dhe vështirësitë në të nxënë

Fëmijët me nevoja të veçanta janë ata fëmijë që kanë ngecje në proceset jetësore. Problemet e tyre dallojnë varësisht nga nevoja e tyre e veçantë në zhvillimin e tyre. Ekzistojnë disa dëmtime që i pengojnë në arritjen e duhur të zhvillimit të tyre, ndër to dallojmë: -

- ngecje në zhvillimin mendor,
- dëmtimet në të folur,
- dëmtimet në të dëgjuar,
- dëmtimet në të parë,
- dëmtimet fizike.

Ka shumë udhëzues për mësimdhënës që gjatë procesit mësimor të zbatojnë strategji të ndryshme, duke iu ofruar nxënësve modele të përshtatshme për lehtësira në nxënie. Arritja e sukseseve për të gjithë mund të arrihet qoftë duke punuar me grupe, qoftë duke punuar individualisht me nxënësit të cilët hasin pengesa gjatë procesit të nxënies. Çdo fëmijë ka të drejtën e arsimit, mirëpo sa janë të përfshirë fëmijët me nevoja të veçanta në arsim? Ne do të shqyrtojmë gjendjen e arsimit në Kosovë, por do të shikojmë edhe ligjin “IDEA”(Individuals with Disabilities Educational Act) në SHBA që merret me arsimin e personave me nevoja të veçanta. Ligji për arsimin e personave me nevoja të veçanta (IDEA) në Amerikë, është ligji federal i arsimit special që i siguron shkollat publike për t’iu shërbyer nevojave të nxënësve me nevoja të veçanta.(NCLD, 2018).

Në nivelin e tij më të përgjithshëm, ligji kërkon që të gjitha shtetet në SHBA të sigurojnë arsim publik falas dhe të përshtatshëm (FAPE) për të gjithë nxënësit me paafësi që trajtohen në kuadrin e arsimimit të veçantë. Nuk ka asnjë përjashtim-ligji kërkon zero përjashtime.Kjo politikë vlen

edhe për nxënësit me sëmundje të transmetueshme, ngjitëse, si SIDA. Shpenzimet për mbulimin e nevojave të veçanta që kanë këta nxënës, konsiderohen si përgjegjësi publike. Ligji përmban tri pika për fëmijët me nevoja të veçanta: konceptin e mjedisit sa më pak kufizues, programet individuale të arsimit (IEP) dhe mbrojtjen e të drejtave, si të fëmijëve me paaftësi, ashtu edhe të prindërve të tyre. (Woolfolk, 2011, p. 124).

IDEA kërkon që prindërit të marrin pjesë në ekipin që diskuton nevojat e të mësuarit të fëmijës dhe përcakton nëse shkolla duhet të kryejë ndonjë vlerësim gjithëpërfshirës, nëse dyshohet se fëmija ka paaftësi në të mësuar. Megjithatë, jo secili fëmijë që ka një paaftësi duhet të kualifikohet për shërbime të edukimit special. Për t'u kualifikuar për këto shërbime, duhet të jenë dy faktorë, fëmija të ketë paaftësi dhe si rezultat i kësaj paaftësie, ka nevojë në mësim, atëherë në këtë rast ai ka nevojë për të bërë progres dhe për të përfituar nga programi i përgjithshëm arsimor. (NCLD, 20018).

Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta, qoftë në institucionet parashkollore ose shkollore, ka filluar të aplikohet disa vite më parë në shumë vende të botës. Inkluzioni në arsim nënkupton barazi në arsimim dhe shkollim. Sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, fëmijët me nevoja të veçanta kanë të njëjtat të drejta sikurse fëmijët e tjerë. Fëmija me nevoja të veçanta “ka të drejtë për kujdes të veçantë, për arsimim dhe trajnim, për t'i ndihmuar që të gëzojë jetë të përshtatshme me dinjitet të plotë dhe të arrijë dinjitetin më të lartë të vetëbesimit dhe mundësi të integritit social”. (Divizioni për arsim me nevoja të veçanta).

Në Kosovë, sipas prindërve, arsimimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe gjithëpërfshirja, mbeten akoma sfida. Po sipas prindërve, mungon përkrahja e institucioneve dhe mungesa e stafit profesionist e bën akoma më të vështirë edukimin dhe arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta.

Në kuadër të Ministrisë së Asimit, Shkencës dhe Teknologjisë, vepron Divizioni për Arsim me Nevoja të Veçanta. Ky division përfshin hartimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave për nxënësit me nevoja të veçanta. Aty përfshihen publikime dhe dokumente për fëmijët me nevoja të veçanta: Funksionalizimi i qendrave burimore, Arsimi gjithëpërfshirës e drejtë e secilit, Dokument i punës për mësimdhënësit mbështetës etj. (Divizioni për arsim me nevoja të veçanta).

Arsimi gjithëpërfshirës është pjesë integrale e të gjitha politikave të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, si e tillë bën të mundur që arsimi në Kosovë të jetë në përputhje me trendet

bashkëkohore të arsimit. Pëpjekjet për arsim gjithëpërfshirës kanë filluar vite me herët, por me ligjin për arsimin parauniversitar 2011 dhe ligjet e tjera, arsimi gjithëpërfshirës tani është realitet dhe si tillë ka bërë që konventi gjithëpërfshirës të bëhet pjesë e të gjitha politikave të MASHT-it. (Arsimi gjithëpërfshirës E drejtë e secilit, 2014). Dokumentet që sigurojnë arsimin gjithëpërfshirës në Kosovë:

- Ligji mbi arsimin parauniversitar 2011
- Korniza e kurrikulumit të Kosovës (KKK)
- Standardet për edukim parashkollor
- Standardet për shkollat mike për fëmijë 15
- Plani Strategjik për Arsimin e Kosovës 2011-2016 (PSAK)
- Plani individual i arsimit PIA-Plani individual i arsimit është dokument zyrtar pedagogjik i cili hartohet për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, për të ekipi vlerësues i ekspertëve të fushave të ndryshme zhvillimore ka marrë vendim për edukimin dhe arsimin e fëmijëve me nevoja të veçanta. (Arsimi gjithëpërfshirës E drejtë e secilit, 2014).

Planet strategjike për gjendjen sociale të personave me nevoja të veçanta

Si kudo në botë, ashtu edhe në Kosovë, ka persona që kanë nevoja të veçanta. Është përgjegjësi e çdo shteti që të sigurojë jetesën e barabartë të këtyre personave. Si çdo person tjetër, edhe ata duhet të ndihen të pranuar e të sigurt në jetën që bëjnë. Kosova si një shtet në zhvillim e sipër, këtyre personave nuk iu ofron kushte të mjaftueshme për sigurimin e një jete të mirëfilltë. Për shkak të diskriminimit që iu bëhet personave me nevoja të veçanta, zhvillohet vazhdimisht fushatë globale nga “Save the Children”, për përmisimin e gjendjes së tyre, ku pjesë e kësaj fushate është edhe Kosova. Përqindja e përfshirjes, edhe pse mungojnë statistikave të sakta, që përfitojnë nga shërbimet sociale, është e vogël. Për zbatimin e politikave dhe planeve strategjike, për fëmijët me nevoja të veçanta, qeveria e Kosovës duhet të ndajë fonde të mjaftueshme. Është e pamundur të realizohen planet dhe zbatohen politikat, nëse qeveria nuk e ndan buxhetin e mjaftueshëm për këta fëmijë. Shërbimet që ofrohen në institucionet tona për personat me nevoja të veçanta nuk janë në nivelin e duhur. Kjo vjen për shkak se qeveria nuk ndan buxhet të mjaftueshëm për zhvillimin e politikave dhe planeve strategjike për përfshirjen e personave me nevoja të veçanta në institucionet publike për zhvillimin e një jete normale si gjithë të tjerët. Qeveria ka hartuar një dokument “Strategjia nacionale për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës 2013-2023”,

me qëllim të promovimit të një shoqërie gjithëpërfshirëse. Ky dokument është hartuar në bashkëpunim me shumë organizata vendore e ndërkombëtare dhe do të shërbejë si një mekanizëm për realizimin e të drejtave të barabarta për personat me aftësi të kufizuara, po sipas Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. (Strategjia nacionale për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës, 2014).

Një pjesë nga përmbajtja e këtij dokumenti:

Qëllimi i kësaj konvente është që të promovojë, të mbrojë dhe të sigurojë gëzimin e plotë dhe të barabartë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nga të gjithë personat me aftësi të kufizuar, si dhe të kontribuojë në respektimin e dinjitetit të tyre të qenësishëm. Personat me aftësi të kufizuar përfshijnë ata që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose shqisore, të cilat në bashkëveprim me pengesa të ndryshme, mund ta pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë edhe efektive në shoqëri në mënyrë të barabartë me të tjerët. (Strategjia nacionale për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar në Republikën e Kosovës, 2014).

Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Kombet e Bashkuara

Me anë të këtij dokumenti strategjik synohet përmirësimi i gjendjes aktuale në këto fusha: shëndetësisë; mirëqenies sociale; punësimit; edukimi; mbrojtjes ligjore; pjesëmarrjes; informimit; komunikimit; qasjes dhe statistikes. Me qëllim të përmirësimit të gjendjes aktuale nga fushat prioritare të përzgjedhura në strategji, janë përcaktuar objektiva strategjike të cilat do të detajohen dhe specifikohen edhe në veprime konkrete, tregues të matshëm, specifike, të arritshëm dhe real. Institucionet përgjegjëse për zbatimin e secilit aktivitet do të ketë një afat kohorë të përcaktuar dhe linjë buxhetore për mbulimin e aktiviteteve të përcaktuara në planin e veprimit për zbatimin e strategjisë. (Strategjia nacionale për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës, 2014).

Qëllimi i hartimit të kësaj strategjie është integrimi i personave me nevoja të veçanta në jetën sociale, politike, ekonomike e kulturore. Ashtu si kudo në botë, edhe në Kosovë bëhen përpjekjet për përkujdesje ndaj të drejtave të individit, dhe në këtë proces hyjnë edhe personat e aftësi të veçanta dhe është përgjegjësi shtetërore që atyre t'iu sigurohen të drejtat e barabarta. (Strategjia nacionale për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar në Republikën e Kosovës, 2014)

Diskriminimi dhe paragjykimi janë sfidat kryesore të jetës sociale. Prandaj është e rëndësishme që në shoqëri, fëmijët me nevoja të veçanta, të mos ndihen të diskriminuar dhe të paragjykuar. Niveli më i ulët i diskriminimit është shmangia, pastaj ka nivele më të larta, siç është përjashtimi nga puna, mospranimi në shkollë, kufizimi i të drejtave elementare.(Dragoti, 1999, p.233).

Procesi i arsimit gjithëpërfshirës në Kosovë

Arsimi gjithëpërfshirës synon të lehtësoj përfshirjen e të gjithë fëmijëve me nevoja të veçanta në arsim. Gjithëpërfshirja nënkupton qasjen e pakufizuar të të gjithë fëmijëve në arsim, si e drejtë e secilit fëmijë.

Arsimi gjithëpërfshirës, si një hap i parë drejt përfshirjes sociale, është në dobi të të gjithë shoqërisë. Në shumë sisteme arsimore të vendeve të ndryshme, gjithëpërfshirja është bërë tashmë realitet, por i shoqëruar me vështirësi të shumta. Me këtë sfidë po ballafaqohet edhe Kosova, e cila po bën përpjekje në drejtim të realizimit të konceptit të arsimit gjithëpërfshirës. (2014. p. 4).

Njohja e ligjeve, respektimi dhe zbatimi i tyre lehtësojnë në mënyrë të theksuar procesin e gjithëpërfshirjes në arsim.

“Save the Children” ka paraqitur një indeks si instrument që ua lehtëson shkollave zhvillimin e arsimit gjithëpërfshirës. Në këtë indeks tregohet për gjendjen e arsimit gjithëpërfshirës në Kosovë:

Në Kosovë janë hedhur hapa të rëndësishëm drejt hapjes së shkollave të rregullta, si për fëmijët me nevoja të veçanta, ashtu edhe për fëmijë të tjerë, mirëpo ky proces po has në disa pengesa, sidomos në të kuptuarit të drejtë të konceptit të arsimit gjithëpërfshirës nga institucionet arsimore nga niveli qendror deri në nivelin shkollorë. Ministria e Arsimit e Shkencës dhe Teknologjisë, arsimin gjithëpërfshirës e ka përfshirë si filozofi, e cila i përshkon të gjitha politikat e saj duke filluar nga legjislacioni e deri të dokumentet e tjara përcjellëse, të cilat e promovojnë arsimin gjithëpërfshirës. (Zabeli & Behluli, Save the children Kosovo, 2014).

Vështirësitë më të mëdha në gjithëpërfshirje janë hasur për fëmijët me nevoja të veçanta. Në Kosovë, si një vend në zhvillim e sipër, ka nevojë për contribute nga ana e qeverisë, e organizatave botërore, në mënyrë që për fëmijët me nevoja të veçanta të krijohen kushte të përshtatshme për gjithëpërfshirjen në arsim. Pavarësisht se janë hedhur hapa në përmissimin e gjendjes, prapëseprapë, sipas prindërve, në Kosovë akoma nuk është arritur gjithëpërfshirja e fëmijëve me

nevoja të veçanta, kjo si pasojë e mosvetëdijesimit të familjarëve për arsimin e fëmijëve si dhe mosplotësimi i kushteve në institucione arsimore. Mungesa e stafit të specializuar nëpër institucionet arsimore mbetet një sfidë tjetër që Kosova nuk e ka plotësuar. Janë organizatat e shumta që veprojnë në Kosovë, ato, që vazhdimisht kujdesen për organizime të ndryshme me qëllim të përkrahjes së zhvillimit të procesit gjithëpërfshirës në arsim. Përmes punimeve të ndryshme si dhe trajnimeve të shumta me mësimdhënës, këto organizata kanë dhënë kontributin e tyre për të zhvilluar edukimin dhe arsimin gjithëpërfshirës të fëmijëve me nevoja të veçanta. Të gjitha këto veprime janë bërë në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Në hulumtimin “Sfidat e integritit të nxënësve me dëmtime në të parë në Kosovë” nga Prof. Dr. Shefqet Mulliqi, mësimdhënësit janë të prirë të kenë qëndrim kritik ndaj përfshirjes së mirëfilltë të fëmijëve me dëmtim në të parë në procesin arsimor, po ashtu edhe prindërit. (Mulliqi, 2016, p.15). Një ndër orientimet strategjike të MASHT-it për zhvillimin e sistemit të arsimit është hartimi i politikave gjithëpërfshirëse dhe krijimi i mekanizmave për zbatimin e tyre. (2016, p. 20)

Gjatë viteve 2008-2013, numri i fëmijëve me nevoja të veçanta në arsim është rritur nga 909 në 6093. MASHT-i I ka kushtuar vëmendje përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta, dhe me mbështetjen e partnerëve zhvillimor ka krijuar një mjedis më të mirë për ta. Pesë shkolla speciale janë shëndërruar në qendra burimore, me qëllim të lehtësimit të integritit të fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollat e rregullta, në vend të ndarjes së tyre në shkolla speciale. (2016, p. 140).

Fëmijët me nevoja të veçanta dhe edukimi special

Edukata dhe edukimi parashkollor institucional, në ent, ka për objektiv organizimin e situatave jetësore, të përshtatshme për fuqinë kuptimore të nxënësve që këta të vërejnë, sillen e veprojnë, të mësojnë e nxënë duke imituar veprimet dhe sjelljet e edukatores dhe ato të seleksionuara të njërit-tjetrit, të mësojnë nga përvoja e të tjerëve dhe të formojnë përvojë vetanake edhe duke nxënë njohuri, zhvilluar aftësi e shkathtësi dhe formuar shprehje elementare higjienike, kulturore dhe punuese për t’u aftësuar për jetë të pavarur në mjedisin social dhe natyror. (Brada, 2013, p.16)

Personat me nevoja të veçanta janë ata persona që kanë kufizime fizike apo mentale dhe gjendja e tyre kërkon kujdes të veçantë. Fëmijët, që u duhet kujdes i veçantë gjatë procesit të rritjes, janë

fëmijë me nevoja të veçantë dhe si të tillë kanë të drejtë të jenë të përfshirë barabartë me fëmijët e tjerë.

Tek të drejtat e personave me nevoja të veçanta përfshihen:

1. E drejta për shkollim,
2. E drejta për qasje të lirë në institucione shkollore,
3. E drejta për shërbime shëndetësore,
4. E drejta për mirëqenie sociale. (Wikipedia, Personat me nevoja të veçanta, 2017).

Pavarësisht të drejtës për arsim, të fëmijëve me nevoja të veçanta, në Kosovë mbetet sfida sigurimi i kushteve për arsimimin e duhur të këtyre fëmijëve. Mungesa e stafit të specializuar bën që këta fëmijë me vështirësi të arrijnë mësimet sikur fëmijët e tjerë. Njëra ndër detyrat më të rëndësishme të MASHT-it është qasja e barabartë për edukimin e të gjithë fëmijëve, sepse shkollat nuk janë vetëm burim i dijes por edhe një shok i lojës, si dhe një kontest shoqëror (social) për fëmijët me nevoja të veçanta. (Kosovo, 2003, p. 34).

Ministria e Arsimit ju ofron fëmijëve me nevoja të veçanta përfshirjen në institucionet shkollore si në: qendra burimore, institucione parashkollore, klasa të bashkangjitura në kuadër të shkollave të rregullta etj.

Monitorimin dhe identifikimin e nevojave të veçanta të fëmijëve e bëjnë edukatorët dhe mësimdhënësit në institucionet shkollore, në mungesë të edukatorit mbështetës të specializuar. Është e rëndësishme që këta fëmijë të marrin kujdesin dhe trajtimin e duhur.

Me edukimin dhe arsimimin e nxënësve, me nevoja të veçanta, merret edukimi special. Përmes veprimeve special synohet të arrihet niveli i kënaqshëm i arsimimit dhe edukimit fëmijëve që hasin pengesa në rrugën e zhvillimit të tyre. Për shkak të nevojës së trajtimit të veçantë, këta fëmijë kanë nevojë për metoda speciale në edukimin e tyre.

Pra, edukimi special merret me edukimin dhe arsimimin e fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve me nevoja të veçanta, si pasojë e çrregullimeve të:

- Parët
- Dëgjimit

- Fizike
- Psikike
- folurit
- devijimeve të sjelljes, si dhe atyre të
- kombinuara apo të shumëfishta. (Devolli).

Varësisht prej pengesave, personat me nevoja të veçanta, kanë nevojë për trajtim të veçantë profesional si p.sh personat me pengesa në të parë kanë nevojë për profesionist të specializuar në të parë, personat me pengesa në të folur kërkojnë ndihmën nga logopedi etj.

Sipas Brestovcit (1983), në kuptimin shkencor të edukimit special, si pengesë në zhvillimit merret ajo pengesë që e pengon dukshëm zhvillimin e personalitetit të fëmijës, të riut apo të rriturit në procesin edukativo-mësimor, në aftësimin profesional, në kryrjen e profesionit të zgjedhur apo në integrimin e përgjithshëm shoqëror. Njëra ndër nocionet më të vjetra, që është përdorur fillimisht në Rusi, është nocioni i defektit që rrjedh nga fjala defectus, që do të thotë mungesë. Mirëpo për shkak të natyrës nënçmuese që ka ky nocion, me kalimin e kohës u hoq nga përdorimi. Organizata Botërore e Shëndetësisë (1980), i ka dhënë këto definicione përkitazi me pengesat psikike dhe fizike. (Devolli):

1. Lëndimet: lëndime të përhershme apo të përkohshme me karakter psikologjik, fiziologjik dhe trupor, apo anomalia e strukturave ose funksioneve të organizmit të njeriut;
2. Invaliditeti: çdo kufizim apo pengesë në aksion si pasojë e lëndimeve në atë formë dhe nivel, i cili merret si normal për qenien e njeriut;
3. Handikapi: invaliditeti i cili ndikon në gjendjen joadekuate të individit në kuptimin e kufizimit apo të pengesës për ta realizuar rolin normal, varësisht nga mosha, gjinia dhe faktorët shoqërorë e kulturorë të rrethit për individin përkatës. (Devolli)

Edukimi special, në histori ka kaluar në disa periudha. Sipas hilumtimeve të bëra, janë tri periudha:

1. Periudha e të kuptuarit primitive,
2. Periudha e azileve,
3. Periudha e integritit social. (Devolli).

Në kohërat primitive, personat me nevoja të veçanta janë konsideruar si barrë dhe si të tillë nuk kanë pasur përkrahje dhe as mundësi integrimi social. E në periudhën e integritit social, përkujdesja ndaj personave me nevoja të veçanta arrin një nivel më të lartë duke iu mundësuar metoda për arsimin dhe edukimin. Në vendet në zhvillim e sipër mbetet sfida sigurimi i kushteve për arsimin të personave me nevoja të veçanta. Nuk ka mjaftueshëm fonde për hapjen e institucioneve special. (Devolli).

Edukimi special në Kosovë

Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta, qoftë në institucionet parashkollore ose shkollore, ka filluar të aplikohet disa vite më parë në shumë vende të botës dhe është implementuar në mënyra të ndryshme. Në disa vende të botës, si në ShBA, e veçmas në disa vende të Evropës Perëndimore, idetë për integrimin e fëmijëve në shkolla të rregullta nisën në fillim të viteve të 60-ta të shek. XX. Tani në shumë sisteme arsimore të disa vendeve, inkluzioni është bërë realitet, por i shoqëruara me vështirësi të pritshme. (Kosovo, 2003, pp. 7-8).

Fëmijët me nevoja të veçanta kanë nevojë për kujdes të veçantë dhe jo për të drejta të veçanta. Shkolla inkluzive i zgjidh problemet dhe ofron shanse të barabarta për edukim të gjithëve pa as më të voglin dallim. Në shkollë inkluzive, fëmija me nevoja të veçanta bëhet:

- ❖ Pjesë e barabartë e grupit;
- ❖ Përfshihet bashkërisht me të tjerët në procesin e të nxënës;
- ❖ Përfshihet në të gjitha aktivitetet e shkollës;
- ❖ Bëhet i vetëdijshëm se është person sikurse të tjerët, etj. (Kosovo, 2003, p. 8).

Vazhdimisht punohet në procesin gjithëpërfshirës të fëmijëve me nevoja të veçanta në institucionet arsimore në Kosovë. (Wikipedia, Personat me nevoja të veçanta, 2017).

Përgjegjës për zhvillimin e arsimit publik, në këtë rast edhe të fëmijëve me nevoja të veçanta, është MASHT. Duhet të hartojë përmbajtje të përshtatshme mësimore për fëmijëve me nevoja të veçanta. Ata e kanë të drejtën e arsimit special, sipas ligjit. 35.1 Nxënësit që nuk përfitojnë ose që nuk kanë mundësi të përfitojnë mësimdhënie të zakonshme në mënyrë të kënaqshme, kanë të drejtë për arsim special dhe është detyrë e komunës ta sigurojë këtë arsim, në bazë të dispozitave të këtij

ligji dhe brenda kufijve të buxhetit komunal. Ende në Kosovë nuk ka kuadër për fëmijëve me nevoja të veçanta. (2006, p.101).

Identifikimi, diagnostifikimi, trajtimi, aftësimi i fëmijëve me nevoja të veçanta për arsim special do të jetë strategji afatgjate e MASHT-it. Për të arritur qëllimet e një sistemi të arsimit gjithëpërfshirës, nevojiten synimet në vijim:

- Qasje e barabartë në arsim e të gjithë fëmijëve me dëmtime, si dhe përgatitja në të gjitha nivelet arsimore;
- Të ngrihet vetëdija e të gjithëve për arsimimin në pajtueshmëri me principet e të drejtave njerëzore;
- Miratimi i legjislacionit që ka qasje jodiskriminuese në arsim, brenda sistemit arsimor gjithëpërfshirë që të krijojë kushte në çdo nivel arsimi. Kosova, është akoma në hapat e zhvillimit, prandaj edhe vështirësitë janë më të mëdha, por planet strategjike për arsim gjithëpërfshirës nuk mungojnë dhe vazhdimisht punohet në këtë drejtim.
- Të zhvillohet sistemi gjithëpërfshirës arsimor (sistemi i njëjtë arsimor) për të gjithë;
- Të ndihmohet qasja e hershme në arsim për të gjithë nxënësit, duke u përfshirë në institucionet parashkollore për të lejuar intervenimin sa më të hershëm;
- Të ekzistojë një plan i hollësishëm për të gjithë, duke angazhuar mësuesit e arsimit të nevojave të veçanta si përgjegjës në këtë drejtim. (Kosovo, 2003, p.26).

Këta fëmijë duhet të marrin njohuri arsimore si çdo fëmijë dhe është përgjegjësi e MASHT-it që të krijojë kushte në çdo nivel arsimi. Kosova, është akoma në hapat e zhvillimit, prandaj edhe vështirësitë janë më të mëdha, por planet strategjike për arsim gjithëpërfshirës nuk mungojnë dhe vazhdimisht punohet në këtë drejtim. Për identifikimin e pengesave të fëmijëve nevojitet njohuri profesionale të edukimit special, prandaj ka shumë rëndësi përgatitja profesionale që kanë mësimitdhënësit, edukatorët, pedagogët etj. Për arritje të kësaj, në Kosovë, ka nevojë që të punohet shumë.

Roli i prindërve në edukimin special

Qëllimi i çdo prindi është edukimi sa më i mirë i fëmijëve të tyre, në mënyrë që me edukimin e tyre t'iu sigurojnë një të ardhme të mirë. Synimi i prindërve është t'iu orientojnë fëmijët e tyre në

edukim të denjë dhe t' i bëjnë të dobishëm për të ardhmen. Pasi që mësimet e para merren nga prindërit, është shumë i rëndësishëm roli i tyre në rritjen dhe zhvillimin e fëmijës. Rëndësia rritet tek fëmijët me nevoja të veçanta. Zakonisht janë prindërit ata që identifikojnë nevojat e veçanta të fëmijëve. Është e rëndësishme që prindërit, të cilët identifikojnë paafësi të caktuara tek fëmija, ta pranojnë këtë fakt dhe të kujdesen që ata të marrin trajtimin dhe edukimin e duhur. Në momentin që prindi e pranon që fëmija i tij ka probleme apo vështirësi në një aspekt të caktuar, ta orientojë atë në institucionet e edukimit special. Sa më herët që bëhet identifikimi i fëmijës me nevoja të veçanta, aq më e mirë është mundësia për gjetjen e formës adekuate të edukimit. Sigurisht që këtë nuk mund ta bëjnë vetëm prindërit, por me bashkëpunimin e prindërve bëhet më i lehtë identifikimi.

Prindërit e njohin më së miri personalitetin e fëmijës së tyre, se cilat situata janë të vështira, si dhe cilat aktivitete janë të pëlqyeshme për fëmijët. Kështu që është e domosdoshme që 20 prindërit të ftohen si partnerë për të planifikuar edukimin për fëmijët e tyre. Ndërtimi i partneritetit me prindër fillon që nga kontaktet e para. Ndjenja e të qenit bashkërisht dhe e diskutimeve të hapura janë pasojë e një bashkëpunimi dhe punë ekipore të suksesshme. Sugjerimet në vijim mund të ndihmojnë në mbajtjen e takimeve:

- Inkurajon prindërit dhe ndërton optimizëm drejt edukimit të fëmijës;
- Paraprakisht jepni informata të mjaftueshme lidhur me takimin, kështu që prindërit të dine se çfarë të presim në takim;
- Rezervoni kohë të mjaftueshme për takime;
- Sigurohuni që prindërit të kenë hapësirë për të shprehur pikëpamjet e tyre dhe se ato janë të çmuara;
- Mbani gjërat të thjeshta dhe shmanguni terminologjisë së ndërlikuar profesionale;
- Shkruani vendimet qartazi dhe sigurohuni që prindërit t' i kanë kuptuar ato. (Kosovo, 2003, pp. 38-39).

Për të pasur sukses procesi gjithëpërfshirës, është i nevojshëm bashkëpunimi në mes të prindërve dhe mësimeve, prandaj është shumë e rëndësishme që prindërit, duke i njohur më së miri karakteret e fëmijëve të tyre, t' i japin mundësinë fëmijës që të integrohet sa më mirë në shoqëri.

Politikat Sociale

Politikat sociale kanë të bëjnë me krijimin e metodave për të siguruar mirëqenien e çdo kategorie të shoqërisë.

Objekti i politikës sociale përfshin të drejtat e individit për siguruar:

- mjetet e domosdoshme materiale për jetesën si: ushqimin, veshjen dhe strehimin;
 - zhvillimi normal fizik/mendor si qenie njerëzore, për të shmangur sëmundjet të ndryshme, paaftësinë;
 - zhvillimi normal i marrëdhënieve ndërpersonale, marrëdhëniet bashkëshortore, ato prindër-fëmijë, etj.;
 - mundësi të barabarta në edukim, shërbim shëndetësor, shërbime sociale, punësim etj.
- (Xhumari, 2003, p. 3).

Këto të drejta sociale ligjërohen në forma të ndryshme si:

- a) në dokumentin themeltar të shtetit, kushtetutën, ku shpallet shteti social;
- b) në kushtetutë ato shpallen si të drejta themelore të shtetasve;
- c) në ligje të veçanta, si ato për sigurimet shoqërore, sigurimin e kujdesit shëndetësor, ndihmën sociale, shërbimet e punësimit, ku kalohet nga të drejtat e përgjithshme të përcaktimi i përfitimeve konkrete;
- d) ka raste kur në kushtetutë kompetencat në lidhje me garantimin e këtyre të drejtave sociale mund t'u atribuohen institucioneve përkatëse. (Xhumari, 2003, pp. 3-4).

Duke marrë parasysh se përmbajtjet e politikës sociale janë të shpërndara dhe të shumëfishta, ato mësohen në shumë disiplina shkencore, prandaj ky fakt tregon se politikat sociale paraqiten në menyra të ndryshme. Pra, mendimet e ndryshme të definimit dhe kuptimit të politikës sociale në një anë rrjedhin nga qasjet e ndryshme filozofike, teorike, politike dhe ideore. Termi "politika sociale" përdoret që nga viti 1851, së pari në punimet e historianit gjerman Ril, prej se është në përdorim konsekuent. Termi "politikë" është me origjinë të vjetër greke, e kanë zhvilluar filozofët duke shpjeguar aktivitetin e përditshëm të njerëzve në punët e qeverisjes dhe vendosjes në kushtet e demokracisë skllavopronare. Termi "sociale" është me prejardhje latine dhe tregon shoqërinë, bashkësinë shoqërore, edhe pse jo rrallë përdoret edhe për të treguar mjediset subkulturore, të

ashtuquajtura si “mjedise sociale”. Në politikën sociale, termi sociale ka të bëjë me kompleksitetin e paraqitjes së fenomeneve dhe rrethanave shoqërore, të cilat kanë të bëjnë me kushtet e jetesës dhe kushtet e punës së njerëzve, qoftë të shoqërisë në tërësi, qoftë të grupeve apo individëve në veçanti. Sipas domethënies së tretë, termi sociale përfshin vetëm ato paraqitje dhe rrethana të fenomeneve shoqërore që kanë të bëjnë me vështirësitë jetësore të njerëzve, të reflektuara si raste sociale (sëmundjet, vdekjet, invaliditetet, papunësia, varfëria etj.). (Skenderi, 2010, pp. 17-18).

Politikat sociale mbulojnë të gjitha dispozitat dhe masat që synojnë të parandalojnë, të mënjanojnë ose të lehtësojnë situatat e varfërisë dhe problemet sociale, në nivel individual ose kolektiv, ose që kërkojnë të favorizojnë mirëqënien e grupeve më të brishta të shoqërisë. (Politikat Sociale).

Në grupet më të brishta të shoqërisë janë edhe personat me nevoja të veçanta, prandaj është i nevojshëm sigurimi i politikave të përshtatshme për t’ua lehtësuar situatat me të cilat përballen qoftë në arsim, shëndetësi, punësim e në kushtet e jetesës. Ndërmarrja e masave të nvojshme për lehtësimin e vështirësive jetësore të këtyre kategorive përfshin politikat sociale.

Politika e mirëfilltë sociale nuk është ide, nuk është as projekt i caktuar shkencor për shoqërinë në një kohë të caktuar. Kërkesat e përhershme jetësore të njeriut dhe lëvizjet e përgjithshme të tijë përherë progresive në aspektin ekonomik, social, kulturor e politik, padyshim që imponojnë nevojën për një politikë më të begatë sociale. (Skenderi, 2010, p.27).

Politikat sociale mbulojnë të gjitha dispozitat dhe masat që synojnë të parandalojnë, të mënjanojnë ose të lehtësojnë situatat e varfërisë dhe problemet sociale, në nivel individual ose kolektiv, ose që kërkojnë të favorizojnë mirëqënien grupeve më të brishta të shoqërisë (Politikat Sociale).

Diskutim për bazat ligjore të politikës sociale në Kosovë

Politikat sociale kanë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e një shteti, prandaj edhe Kosova si një vend që synon Bashkimin Evropian, i kushton rëndësi politikave sociale duke i dhënë një rol të madh drejt rrugës evropiane. Në këtë kapitull do të shqyrtojmë bazën ligjore të politikave sociale në Kosovë. Dihet që Kosova është një ndër shtetet me papunësinë më të madhe në vendet e Evropës si dhe me një ekonomi të dobët. Prandaj edhe mundësia e krijimit të mekanizmave për trajtimin e duhur të kategorive me gjendjen më të rendë në Kosovë, siq janë personat me aftësi të kufizuara, është i vështirë. Mirëpo ekziston baza ligjore që rregullon aspektin juridik të kategorive sociale.

Ligji i cili u siguron mjete monetare mujore për rastet sociale është “Ligji për skemën e ndihmës sociale në Kosovë”. Ky ligj është themeluar me qëllim të mbrojtjes sociale të kategorive më të vështira. Në këtë kategori hyjnë familjet e varfra, invalidët, personat në nevojë, prsonat me aftësi të kufizuara, pensionistët etj. Përmes kësaj synohet të arrihet lehtësimi i kushteve të jetesës për personat që kanë nevojë për ndihmë sociale. Përzgjedhja e personave që kanë nevojë për ndihmë sociale bëhet përmes kornizës ligjore sipas kritereve të parapara. Mjetet ndahen nga buxheti i Kosovës. Në nenin I të këtij ligji thuhet : Me këtë ligj rregullohet skema e ndihmës sociale me qëllim të mbrojtjes dhe përkujdesjes të familjeve të rrezikuara në aspektin social. (2003, p.1). Pasi që tema është e fokusuar në trajtimin social të fëmijëve me nevoja të veçanta, do të shqyrtojmë vetëm bazën ligjore në Kosovë për këtë kategori. Rregullimi ligjor për të drejtat e kategorive të caktuara sociale , në Kosovë, është si më poshtë :

- ❖ Ligji për skemën e ndihmës sociale në Kosovë,
- ❖ Ligji për shërbimet sociale dhe familjare ,
- ❖ Ligji nr. 04/ L-131 për Skemat pensionale të financuara nga shteti,
- ❖ Ligji nr. 03/ L-019 për aftësimin , riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara,
- ❖ Ligji nr. 03/L-022 për përkrahje materiale të fëmijëve me aftësi të kufizuar të përhershme,
- ❖ Ligji nr 03/L-100 për pensionet e pjestarëve të trupave mbrojtëse të Kosovës,
- ❖ Ligji nr 02/L-2 për statusin dhe të drejtat e familjarëve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, dje pjestarëve të UÇK- së dhe viktimave civile të luftës.

Ligji Nr.04/L-131 Për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti

Ky ligj përcakton këto pensione, të cilat financohen nga shteti: pensionet bazike të moshës, pensionet kontribut-pagese të moshës, pensionet e aftësisë së kufizuar, pensionet e parakohshme, pensionet familjare dhe pensionet invalide të punës, si pensione të Shtyllës së I-rë të financuara nga shteti. Po ashtu përcaktohet skemat e aplikueshme pensionale në Kosovë, të cilat financohen nga Buxheti Shtetëror i Kosovës.

1. Ky ligj përfshin Skemën e Pensionit Bazik të Moshës, Skemën e Pensionit Kontribut-pagues të Moshës, Skemën e Pensionit të Aftësisë së Kufizuar dhe Skemën e pensionit

të Parakohshëm, si dhe rregullon qështjet e pensionit familjar dhe invalide të punës, në rastet kur kontribuesit lëndohen në punë apo fitojnë sëmundje profesionale.

2. Krijon metodologji sipas së cilës vlera e pensioneve harmonizohet dhe përfshatet me rritjet e kostos së jetesës.
3. Përcakton procedurat administrative përmes të cilave personat mund të aplikojnë për përfitimin e pensioneve.
4. Adreson trajtimin e qështjeve të pagesave të tepërta dhe pensioneve të papaguara.
5. Krijon një process, sipas të cilit personat mund të rishikojnë kushtet e pranimit për pension.
6. Krijon një rregull tranzicioni që iu takon personave që marrin pagesat e pensioneve në skemat dhe programet pensionale ekzistuese që janë duke u zbatuar; si dhe,
7. Rregullon qështje të tjera nga skemat pensionale të përcaktuara me këtë akt ligjor, të cilat janë në interes dhe favor të shfrytëzuesve pensionistë.

Kriteret për njohjen e së drejtës në pension të paaftësisë së përhershme janë kriteret të përcaktuara me këtë ligj që janë: të jetë shtetas i Republikës së Kosovës, që i kanë tetëmbëdhjetë vjet si dhe të kenë të parashtruara kërkesat për pension të cilat vlerësohen nga komisioni mjekësor. Person me paaftësi të përhershme konsiderohet ai person që ofron dëshmitë mjekësore, komisioni e vlerëson si person me paaftësi të përhershme, varësisht për sa vite si dhe pas skadimit të afateve të përcaktuara në këtë ligj, personi i nënshtrohet procesit të rivlerësimit mjekësor.

Ligji Nr.03/L-019, Për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara. Ky ligj rregullon të drejtat për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të veqanta për qasjen e tyre në tregun e hapur të punës. Ky ligj ka për qëllim përkrahjen institucionale dhe përgaditjen profesionale të personave me aftësi të kufizuara për punë të përshtatshme dhe mundësimin e trajtimit të barabartë.

Personat me aftësi të kufizuara për punë kanë të drejtën për përfitimin e pensioneve dhe ndihmës sociale sipas dispozitave ligjore. Ata i kanë të drejtat e barabarta për punësim, pa asnjë lloj diskriminimi, atyre u sigurohet mbrojtja ligjore në rast diskriminimi.

Sipas këtij ligji, disa nga procedurat për vlerësimin e aftësisë për punë të personave me aftësi të kufizuara janë: aftësitë për punë i përcakton komisioni vlerësues, fillimi i procedurës për

vlerësimin e zvogëlimit të aftësisë paraqitet me kërkesën e personit me aftësi të kufizuara, kërkesa duhet të përmbajë të gjitha dokumentet e nevojshme të kërkuara sipas ligjit.

Po sipas këtijë ligji, personi me aftësi të kufizuara ka të drejtë në aftësim, riaftësim profesional sipas kushteve të parapara me këtë ligj. Në rastet kur është e nevojshme, aftësimi dhe riaftësimi mund të bëhet në shkolla të veqanta dhe në institucione përkatëse. Punësimi i personave me nevoja të veqanta nënkupton punësimin e tyre në tregun e hapur të punës dhe sektori public dhe ai privat janë të obliguar që t'i punësojnë personat me aftësi të kufizuara.

Ligji Nr. 03/L- 022 Për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuar të përhershme

Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar ligjin që u siguron mbrojtje financiare familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme. Me këtë ligj rregullohet e drejta për përkrahje materiale familjeve të cilat ruajnë dhe përkujdesen për fëmijet me aftësi të kufizuar të përhershme dhe mënyra e realizimit të kësaj përkrahjeje materiale. Sipas nenit 3 të këtijë ligji, sigurohet mbrojtja sociale, për këtë kategori të fëmijëve, duke iu ofruar përkrahje materiale:

- 3.1 Me qëllim të mbrojtjes së fëmijëve me aftësi të kufizuar të përhershme, Ministria e punës dhe Mirëqënies sociale, përpilon strategjinë e vet për këtë kategori të fëmijëve.
- 3.2 Ministria e punës dhe Mirëqënies sociale, siguron përkrahje materiale familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme, në pajtim me mundësitë buxhetore të Kosovës.
- 3.3 Ndhima materiale familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme, do të ofrohet nga Ministria e Punës dhe Mirëqënies Sociale, përmes departamentit të sajë të Mirëqënies Sociale.
- 3.4 Ndhima materiale mundëson fëmijët me aftësi të kufizuar të përhershme të bëjnë një jetë normale në kushtet që garantojnë dinjitetin e tyre dhe lehtësojnë jetën e tyre.
- 3.5 Ndhima materiale për fëmijën e me aftësi të kufizuar të përhershme paguhet në emër të prindit apo kujdestarit të fëmijës, përmes xhirollogarisë bankare.

Ndërsa sipas nenit 6, fëmijë me aftësi të kufizuara konsiderohen:

- a) fëmijët (?)
- b) fëmijët e verbër si dhe,

- c) fëmijët për shkak të natyrës së sëmundjes apo sëmundjeve të përhershme, nuk janë të aftë që në mënyrë të pavarur të lëvizin vetë, në banesë, apo në vendet ku kanë nevojë, as në përdorimin e ndihmesave përkatëse, nuk janë në gjendje të ushqehen vetë, të zhvishen dhe të vishen, të kryejnë nevojat fiziologjike si dhe të mbajnë higjienën e domosdoshme personale. (Ligji Nr. 03/L- 022 Për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuar të përhershme, 2008).

Për procedurat e njohjes së të drejtës në ndihmë e kujdes formohet komisioni vlerësues mjekësor i përbërë nga personat adekuatë. Mjetet për përkrahje financiare sigurohen nga buxheti i Kosovës.

Konkluzione

Përgjegjës për identifikimin e fëmijëve me nevoja të veçanta janë prindërit, edukatorët, dhe mësëdhënësit, ndërsa ligjërish përgjegjëse janë institucionet shtetërore. Gjatë punës me fëmijë mund të vërehen aftësitë e kufizuara gjatë procesit të rritjes. Pasi që, shumë prindër, për shkak të paragjykimeve, hezitojnë t' i dërgojnë fëmijët e tyre me nevoja të veçanta në shkollë, institucionet shtetërore janë përgjegjëse për të identifikuar dhe monitoruar këta fëmijë. Një gjë e tillë mund të arrihet përmes bashkëpunimit në mes të institucioneve arsimore dhe atyre shëndetësore e të mirëqenies sociale. Shpesh terminologjia e përdorur për këta fëmijë nuk është e qëlluar, pavarësisht se kohëve të fundit ka ndryshime. Kemi dëgjuar shpesh termat “fëmijë të hendikepuar, me të meta, jonormalë apo të deformuar, mirëpo këta terma nuk janë të përshtatshëm. Këta fëmijë nuk kanë asgjë tjetër veçse nevoja të veçanta, këto specifikohen si pengesa në të folur, në të parë, në të dëgjuar, apo ngecje në zhvillimin mendor. Ata nuk janë me të meta, por thjesht kanë nevojë për kujdes të veçantë. Për të arritur këtë, duhet identifikuar me kohë nevojat e tyre të veçanta, në mënyrë që ta marrin me kohë kujdesin e duhur dhe të arrijnë qëllimet në jetë si të gjithë të tjerët.

The social aspect and impact of social policies for children with special needs in Kosovo

The purpose of this paper is to investigate the situation of children with special needs in Kosovo. By analyzing and understanding the social situation of children with special needs, I have explored and suggested methods for improving their situation. I have also analyzed the state of education

of children with special needs in order to assess the educational conditions for these children. This paper will provide a research of international and local social policies on the rights of children with special needs as well as the real aspect of the current situation of children with special needs. This research will try to determine the current state of children with special needs in Kosovo, including every aspect: social, economic, educational, social, etc. Children with special needs are a category in need of detailed study and statistical research on their situation in Kosovo. The importance of this topic lies in real information on the conditions, laws and social inclusion of children with special needs. Through this topic, I aim to present the real situation of this category and to specify the shortcomings I will notice in the social treatment of children with special needs. Inclusive process in education will also be explored as another challenge for children with special needs. The steps taken by the Ministry of Education and various international organizations operating in the country to develop this process in a qualitative manner will be reviewed. Through the prepared questionnaires we will come to a conclusion on the educational situation of children with special needs and their treatment by society.

Keywords: children with special needs, social policies, legal frameworks, blind children, children with Down syndrome.

Introduction

